

# GURAS

REVISTË E NXËNËSVE TË GJIMNAZIT "CAMBRIDGE" Nr.4



PËR TU BËRË DIKUSH DUHET TË JESH I DITUR  
PËR TË QENË I DITUR,  
TË MËSOSH E TË LEXOSH SHUMË

Cambridge, 2012



# REDAKSIA

## GURAS

Revistë e gjimnazit

"Cambridge"

Nr.4

[www.Gjcp-ks.com](http://www.Gjcp-ks.com)

[revistaguras@hotmail.com](mailto:revistaguras@hotmail.com)

[schoolpeje@gmail.com](mailto:schoolpeje@gmail.com)

tel. 039 432-448

### Këshilli redaktues

Mustafë Lataj

Gentiana Muhaxhiri

### Bashkëpunëtorë

Alberina Dragaj

Evlina Kabashi

Yvesa Jusaj

Arilda Shala

Avni Zeqiraj

Leart Aliçkaj

Doruntina Ukëhaxhaj

### Përgatitja për shtyp

#### dhe dizajni

Florim Beqaj

### Fotografitë

Veton Beqaj

### Shtypi

Dukagjini

Pejë, 2012

### Të dashur lexues,

Ky është numri i katërt i revistës së gjimnazit "Cambridge" dhe botohet, si zakonisht, në prag të festimit të ditës së shkollës- 2Majit.

Nga botimi i numrit të parë të revistës numri i nxënësve të gjimnazit "Cambridge"është shtuar dukshëm dhe me kërkesë të tyre redaksia ka vendosur që ta publikojë sërisht historikun e emrit Guras, mbi të cilin u bë edhe emërtimi i revistës.

Emri "Guras" mund t'ju ketë tingëlluar çuditshëm, i padëgjuar më parë dhe sigurisht jeni kureshtar për të ditur pse pikërisht ky emër. Nga mënyra e fjalëformimit mund të keni kuptuar se ka të bëjë me fjalën gur ( më konkretisht, fjala gur ka të bëjë me fjalën guras), gjithashtu mund ta keni marrë me mend se një shkolle si "Cambridge" i takon të mbajë një emër të tillë, që është simbol i fortësisë, i qëndresës e i pathyeshmërisë. Por, nuk është vetëm simbolika e fjalës ajo që na shtyri të emërtojmë "Guras" revistën tonë. Duke hulumtuar rrëth çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me fjalët e gjuhës shqipe, ramë në gjurmët e fjalës së parë shqipe të dokumentuar, lashtësia e së cilës është marramendëse, respektivisht e hasim në tekstet më të lashta të historisë së njerëzimit, para 29 shekujsh.

### Ja disa fakte:

Në eposin e Homerit tregohet se heroi Ajaks , pas rënies së Trojës, udhëtonte në det dhe arriti tek një ishull i quajtur " Guras Petras"( Gur guri). Sipas filologut Spiro Konda emri i parë i ishullit ka qenë Gur, por më pas detarët grekë e kanë quajtur Guras petras duke i shtuar emrit të stërvjetër ilir, emrin helenik petras( gur). Por, dëshmitë për përmendjen e fjalës shqipe gur i hasim shumë para Homerit, respektivisht në bibl. Në shumë versione të biblës ("Diodadi i ri", shtypur në Brindisi; në "The Albanian Bible Society", shtypur në Firence") gjejmë të ruajtur korrekt vetëm toponimin Gur, ndërsa toponimet e tjera ndryshojnë. Në "Holy Bible", në "International version" gjemë:"On the way up to Gur near Ibleam..." Në "La Bible", "Nouvelle édition revue"(Paris), gjemë:"À la montée de Gour près Yivleim". Pra, në variantet e biblave të dy gjuhëve kryesore të botës , kemi toponimin Gur. Respektivisht, fjala shqipe gur është përcjellë si toponim që nga "Libri i dytë i mbretëreve" , i cili është shkruar që në shek. IX p.l.K. Në gjurmimet arkeologjike të bëra në Dodonë, u zbulua edhe një tabelë bronzi me emër njeriu Guras. Ky emër ilir gjendet si toponim edhe në Kretë, në Kylkadë dhe Thesali. Historiani antik Arriani, në librin e tij kushtuar Aleksandrit të Madh thotë:" Aleksandri marshoi nëpërmjet një vendi të quajtur "Guraioi", ku kishte edhe një lum me të njëjtin emër. Edhe poeti i madh grek, Arkiloku, përmend në veprat e tij dyfjalëshin iliro- grek " Guras petras". Këto janë vetëm disa nga faktet që tregojnë se fjala gur e ka sfiduar kohën, ajo u ruajt e shkruar për 29 shekuj, ashtu siç, fatkeqësisht, nuk bëri asnjë fjalë tjetër e gjuhës sonë.

Ju urojmë lexim të këndshëm!

**Redaksia**

## Faqja e nxënësve

Redaksia e revistës Guras, falë talenteve të shumta letrare në shkollën tonë, ka vendosur që në çdo numër të revistës të ketë një faqe të veçantë për nxënësit që e duan fjalën e shkruar. Në këtë numër do të lexoni disa nga poezitë e nxënësesh Evlina Kabashi. Evlina është një nxënëse e dalluar e gjimnazit "Cambridge". Këtë vit ajo është maturante dhe nga shkolla e mesme do të largohet me kujtimet më të bukura, pasi në çdo bankë e në çdo klasë e në çdo hapësirë ajo ka lënë të përjetësuara vargjet e saj. Ajo e di si t'i bëjë fjalët të shkëlqejnë mirësi e embëlsi. Vargjet e saj janë të ngrohta e plot ngjyrë.



### Thërrime endrrash

Më duket se qielin kam në duar  
Në atë kohë kur endërroj  
Piklat e shiut lehtas rrëshqasin  
Me thërrime endrrash unë po jetoj

Endrrat e thyera po ribashkohen  
Yjet në qiel kanë më shumë shkëlgim  
Shpirti i frikësuar u qetësua  
Dhe dhembjet po ikin me rrëmbim

Me sy endrrash vështroj ato thërrime  
Sesijeta po ndryshon befasisht  
E pamundura bëhet e mundur  
Endrrat më shumë se kurrë tani vërtet kanë kuptim

S'dua të zgjohem edhe pak  
Këtë enderr ta shijoj pafundësisht  
Për sa kohë prita këtë bashkim endrrash  
Tani zemra po pushon qetësisht

### Ajo e vetmja ajo

Ajo, e vetmja që kurrë s'do të të lëndoj  
Ajo, e vetmja që dhembjet do t'i largoj  
Ajo, e vetmja që të qëndron pranë në çdo rast  
Ajo e vetmja ajo që s'do të të lërë vetëm për asnjë çast  
Ajo që derdh lot për ty  
Por lotin s'do ta shohë në fytyrën tënde  
Ajo e cila mendon për ty pa pushim  
Dhe të këshillon pa mbarim  
Ajo që mundohet të të edukojë  
Në mënyrën më të mirë  
Ajo që gjithnjë të vërtetët ta tregon  
Ajo e vetmja ajo që asnjëherë s'të pikëllon  
Ajo që të përkrah vazhdimisht  
Ajo që dhembjen tënde e ndjen dyfish  
Ajo e cila për buzëqeshjen tënde jeton  
Ajo dhe vetëm ajo  
Është mbi të gjithë  
Nëna që të do

## Faqja e nxënësve

### SËRISH

Një ndjenjë që rrëqeth trupin  
Kaplon shpirtin e mbuluar me dashuri  
Seç ringjallen fijet e shpresës  
Sikur acari zemra ngrin

Ëndrra pa dashje ishte prekur  
Enigma drithëruese më trembi egërsisht  
Minutat rrënojnë hapësirën kohore  
Tingujt e shpirtit dëgjohen në lehtësi

### TI JE

Ti je një yll në kaltërsi  
Dhe vetëm ti shndërrit për bukuri  
Ti je lule  
Plot hijeshi

Ti je engjull  
Plot lumturi  
Je gjithçka që kam në jetë  
Nëna ime, s'të harroj për jetë

Vleri Beqaj kl. VI

Gardian i tingujve dhe dashurisë  
Ringjallet ndjenja e harruar  
Ngrihen sytë në qiellin blu  
Një moment mbetet i kujtuar

Sytë shkëlqejnë si shkëndija  
E brenda vetes qesh me mall  
E ndrojtur nën hije rrija  
Ç'po i mungon qiellit vallë?

### FORCË

Dita-ditës seç po shuhet  
Dhe ai mall që dikur kisha  
Akrepat e orës dot nuk ndalin  
Erdhi momenti që prisja  
Hodha prapa ato ndjenja  
Prapa vetes diçka lash  
Ngriva lotët e shumë përmendur  
Mbylla atë kapitull të vrazhdë  
Jam ngritur përsëri tanë  
Edhe pse poshtë më rrëzoi jetë  
Jam ngritur dhe do vazhdoj  
Kot s'thonë që vret e vërteta!

### S'DUA TJETËR

Jam i huaj, këtë e di  
E kam të vështirë  
Të gjej miç të rinj

S'di të luaj, të ambientohem  
Jam në një vend të panjohur  
Këtë unë shumë mire e di  
Më mungon e ëmbla Shqipëri

Më mungon shqiponja  
Që vjen poshtë e përpjetë  
Më mungon plisi  
Që ka vendin e vet

Tregon burrërinë  
Tregon shpirmirësinë  
Tregon vendin ku kam lind  
Tregon Shqipërinë kaq të madhe  
Tregon zemrën shqiptare

Vleri Beqaj kl. VI



## *Kurorë e vetëkrijuar*

### *NATË PA YJE*

Shiu po troket në dritare, hëna ka humbur ndriçimin, unë e vetme në një dhomë po vështroj qielin, po mendoj se kur ishte hera e fundit kur fytyra ime ka buzëqeshur... kur?! Nuk e mbaj në mend. Jo, nuk e mbaj në mend.

Kjo dhomë e lagur me dysheme të plasur, me mure të prishura, me dritare të thyera po më ngërthen në vete e më bënë t'i kujtoj kohërat e vjetra, vuajtjet, dhimbjet e lotët që kam derdhur, por jo, nuk do ta lejoj këtë gjë, do ta mposhtë këtë poshtërim dhe i them vetes:

Kur ta kujtosh të kaluarën,  
ruaj të mirat,  
harroji të këqijat,  
buzëqesh sonte,  
mendoji dëshirat,  
ndihu mbretëreshë e botës me shumë krenari,  
bëhu armike e sfidave,  
mos lejo të të mposhtin në lumturi,  
karakter i fortë mbizotëron tek ti.

Punuar nga nx;  
Yvesa Jusaj

Beso në dashuri sepse nga një e tillë linde dhe ti. Lindim, gjëzomjmë dikë, bëhemë një arsyë më shumë, një gjëzim më shumë, një shpresë e duhur për jetë. Qajmë kur lindim duke u mësuar nga filimi qëjeta s'do të jetë fare e lehtë.

Pikëllohemë ndonjëherë dhe e kuptojmë sesa vlerë ka lumturia, sesa vlen një fytyrë e buzëqeshur. Janë disa persona që janë pranë nesh çdo moment, personat e vetëm që prekin thellë në zemër dhe aty brenda lënë gjurmë arsyesh për të vazhduar, për të hedhur një hap më tutje. Janë ata prindërit që të rrisin me shumë mund e sakrifika, janë ata që presin të mburren me ty. Mundohu, jep çdo gjë nga vetja, bëji ata krenarë. Të arrish në jetë duhet të mësosh e të lexosh shumë. Ndalu për një moment, mbylli sytë, mundohu të gjesh përgjigjen brenda vetes tënde.

Asgjë në jetë nuk arrihet pa punë, vullnet dhe përkrahje. Kolegji CAMBRDIGE është një hap drejt së ardhmes së ndritur, është një mënyrë e të arriturit në jetë ato që synojmë "Po le shkollën pas dore, koha te sfidon ore pas ore". Mos u ndal edhe pse je penduar për diçka, mundohu të krijosh veten tënde në atë mënyrë që dhe ti të mburresh me veten. Ke gabuar një herë s'është asgjë, vetëm një mësim sesi të vazhdosh tutje. Kolegji CAMBRDIGE ofron çdo mundësi. Mëkat mos të shfrytëzosh mundësitë që të vijnë vetëm një herë në jetë. Të gjithë ne, pra nxënësit e kolegit CAMBRDIGE duhet të ndjehemi me fat që kemi më shumë mundësi drejt një të ardhmeje të ndritur që të gjithë ëndërrojnë.

Vitet e gjimnazit ndryshtë njihen si vitet më të mira të jetës, vitet përplot emocione, eksperienca, ëndrra. Ekskursioni erdhi dhe u plotësua ëndrra e shumëpritur. Me përkrahjen e shkollës dhe të prindërive gjithashtu ne përjetuan momente të paharrueshme, ekskursioni që imagjinonim doli një ëndërr e vërtetë që do mbahet mend si Turqia 2011.

Beso në vete-ti mundesh, bëji të gjithë të ndihen krenar që të kishin ty pjesë të jetës, gjithmonë kujtohu që karakteri është mburoja e të gjithë asaj që ke krijuar. Mos harro edhe ti je ëndrra e dikujt!

Evrina Kabashi XII-2


# Ese



## Ëndërr me ankth

Përse duhet të jem gjithmonë e gjykuar nga të tjerët dhe të jem ajo vajza e lotëve, ndoshta se dashuria që kisha dikur tani u shua, apo u largua nga unë, nga fakti që isha e trishtuar pas atyre gabimeve që kisha bërë apo të tjerët e kishin bere. Dikur isha e dashruar ne ata sy të shkruar që sa herë i shikoja më dukej se nuk kishte asnje bukur tjetër pos syve të tij. Kur ecnim në oborrin e një shtëpie të vjetër që tashme ishte duke u rrënuar, të gjithë na shikonin me lakmi ... Kur dorën ma përkëdhelje zemra rrihte fort dhe lutesha që të dy të ishim të lumtur dhe askush mos të na ndajë edhe pse ishte ëndërr nuk kisha dëshirë të ndahesha nga kjo bukur. Çdo ditë poshtë derës më lije nga një letër që kur e lexoja ma mbushte zemrën plot gjësim. Çdo ditë ishte e njëjtë gjë derisa vinte fundjava dhe takoheshha me ty. Trëndafilat e kuq, në mëngjes, i lije afër kokës bashkë me një zarf të kuq që kur e lexoja shkruante "të dua". Një dite të bukur, dielli shndriste flakë, sytë e tu shkëlqenin, buzët thirrën emrin tim. U shtrive në tokë papritmas; mbi trupin tënd disa njolla të kuqe u shfaqen, nuk kuptova asgjë. Fillova të qaj si fëmijë, kërkoja ndihmë, por askush nuk më ndihmoi. U shtriva, vendosa kokën afër zemrës tënde dhe mbylla sytë. Në ato çaste mendova mos ishte një ëndërr, dhe kur i hapa sytë kuptova se ishte një ëndërr me ankth dhe përsëri sytë tanë shkëlqenin në një ditë te re.

Adriana Zeka



## Dhimbja nga dashuria është dhimbje e bukur dhe e nevojshme

Kjo botë, ky planet, ky horizont do të ishin ta pakuptimta pa dashuri.

Të gjitha gjërat në jetë janë të lidhura nga një pe, nga një pe i hollë dhe i gjatë; sa ngrihesh ne quell sa bie ne toke. Kjo është dashuria.

Nganjëherë nuk është vetëm se mund të vendos të pish tableta, është dhimbja nga dashuria që të bën ta hapësh atë pako të vogël të mbushur me qetësues. Një thikë metali me majë të mprehtë tek një shpirt i lënduar të shtyjnë ta vendosesh në venat e tua. Shikon veten në pasqyrë, një fytyrë e zverdhur e sy të skuqur nga pagjumësia. Një pamje krejt e çrrëgullt. Shikimi të ndalon tek flokët e gjata ngjyrë kafe që dikur kri-heshin nga gishtërinjtë e tij, në duar gërvshërët mban dhe me vete thua :ti prej ato është me mirë.

Të gjitha këto imtësira nuk janë për një të pushuar nga puna, një humbje loje apo një bastisje shtëpie. Të gjitha këto vijnë nga një dhimbje dashurie.

Kam dëgjuar që thonë se duhet pyetur zemrën për ta treguar të vërteten, por unë kuptova se vet çerd-hja e dashurisë është zemra. Sado e dashur dhe e nevojshme të jetë ajo është sikur ora pa akrep !

## Ese

### Lulet e labirintit

Asgjë nuk është ashtu si e shohim. Jeta është një labirint i bukur për t'u parë, por i vështirë për tu kaluar. Jeta është pjesë e jona, ne jemi pjesë e jetës; çdo ditë përballemi me sfidat, të cilat na bëjnë më të fortë për të vazhduar përpara.

E di që nuk ekziston asnje definicion i plotë për jetën. Jeta është ajo e cila çdo ditë ndryshon, herë është aq e bukur e na buzëqesh e nga një herë di të jetë aq e egër sa s'mund t'i bëjmë ballë.

Jeta është enigmë që vështirë mund t'ia gjesh zgjidhjen, është labirint që pothuajse s'mund t'ia gjesh daljen. Por, kjo është jeta e vërtetë, sa mendon se je liruar nga çdo gjë, sa mendon që i kalove problemet, para teje lindi probleme të reja saqë s'e ke idenë se nga erdhën, por me kohën çdo gjë zë vendin e vet. Fjala është nëse punojmë dhe dimë të kujdesemi për jetën pa bërë shumë gabime sepse jeta është vizatim në të cilin s'mund ta përdorim gomën për fshirje. Jeta është pothuajse një oqean i tërë, ndërsa ti je veçse një detar në një barkë të vogël që duhet ta kalosh këtë oqean. Por, ke kujdes, valët e saj të vrullshme, mund të rrëmbejnë dhe të dërgojnë në fund të oqeanit. Jeta është kopsht me lule, me lule të llojullojshme e mbushur me aroma të mrekullueshme, lule të cilat të nxisin t'i prekësh, por mos e bëj këtë gabim sepse shumë lule kanë gjembut e tyre, të cilat mund të lejnë shenjë. Por, kjo është jeta, është një lojë, luaje atë me qëllim që të fitosh, asnjëherë mos u dorëzo; për çdo gjë ka zgjidhje, edhe nëse rrëzohesh ngrihu sepse jeta është aventurë, provoje atë.

Sara Jonuzaj

...

Rrugëtimi ynë nis me provën e ekzistencës sonë. Aty nuk ka dilema, nuk ka „ndoshta” sepse ne nuk mendohemi dy herë kur frymojmë.

Unë e di, të paktën një herë dëshira vdes, dhe ringjallet një shpresë. Askush s'mund ta dijë pa jetuar një herë dhe diçka duhet të vdes për të ringjallur diçka tjetër.

Tek secili nga ne jeton një premtim brenda, dhe nuk është e detyrueshme të përbushet, ti e bën atë çdo ditë, frymon!

Jeta vetë kërkon kështu! Ajo sjell diell dhe shi në ditët tona.

Sjell pikëpyetjet duke kërkuar vetë përgjigjen, por sfidat e saj po aq sa e forcojnë dobësinë tonë aq e forcojnë vetë vullnetin dhe besimin duke u bazuar gjithmonë në rastet e dyta.

Për këtë janë gjërat e bukura, të besojmë dhe t'ia dalim.

Qenia jonë është hija jonë, por ne besojmë në ndjenja, dhe nuk ka asgjë, asgjë më të thellë se egoja jonë!

Rrugëtimi i këtyre fjalëve nuk është i një jete, por vlejnë aq, dhe fshehtësinë që gjendet prapa tyre secili nga ne e gjen në brendësi, o tanë o gjatë udhëtimit jetësor.

Alberina Draga

## Reportazh



Ditë të ngrohta të shtatorit po na shoqëronin në fillimin e vtit shkollor. I shin nga ato ditë që ndjenim kohën që na kishte ikur, ndjenim që ky vit i fundit duhej shfrytëzuar aq shumë sa të marrim nga ai vetëm momente të lumtura, dhe këto momente filluan vërtetë në çastin kur u konfirmua udhëtimi ynë për në Turqi. Akoma pa zbardhur ishim nisur dhe ishim duke udhëtar ndërkokë që dielli po lindte. Ishte agimi më i bukur që kishim parë ndonjëherë dhe s'kishte se si

të fillonte më mirë një udhëtim i tillë. Pasi që u vendosëm në vendin ku do të qëndronim për një javë rresht, filluam t'i shijojmë ato momente; aty ishte e bukur çdo gjë, duke filluar nga prania e njëri-tjetrit, nga bukuria e atij vendi, dhe hoteli ku po qëndronim, i cili plotëson të gjitha dëshirat tona, si pishina të mëdha, ushqime jashtëzakonisht të shijshme dhe personeli i tij, i cili organizonte lojëra të ndryshme çdo mbrëmje që të na argëtonin. Afér hotelit ndodhej edhe një plazh i bukur, në të cilin kalonim qaste shumë të bukura. Të ulur pranë plazhit dhe tek sodisnim bukurinë e freskinë e tij, ishim mbledhur dhe bisedonim, tregonim histori qesharake, histori te marrë nga jeta e secilit dhe së bashku po e jetonim atë aventurë. Në një nga ato net të bucura kishim vizituar qytetin e Alanya's që dukej i magjishëm nén ndriçimin e dritave, kishim ecur rrugëve të atij vendi, kishim blerë dhurata për më të dashurit tanë dhe mbi të gjitha kishim takuar njerëz që jetonin atje, të cilët ndiheshin mirë që po vizitonim vendin e tyre; na tregonin për kulturën dhe historinë e vendit. Pasi mësuam edhe shumë gjëra që më parë nuk i dinim u kthyem përsëri në hotel dhe vazhduam të kënaqeshim si çdo natë tjetër që e kalonim atje. Ditën e parafundit kishim vendosur të shkonim në një vend që quhej "Planet Water", aty ndodheshin toboganë gjigantë që na ofronin kënaqësi të papërshkrueshme. Ishte kjo një ditë që gjatë do ta mbajmë në mend. Të nesërmen vërehej trishtim në fytyrat tona, ishte dita kur çdo gjë përfundonte. Por, ne morëm atë që donim, një kujtim të paharrueshëm që gjithmonë do të mbahet mend, ai ishte një udhëtim i mbushur me plot dashuri, dhe aty ku ka dashuri ka jetë. Kjo javë e paharrueshme zgjati pak, koha na e vodhi shumë shpejt, por ne e jetuam atë dhe kujtimet vazhdojnë të jetojnë këtu me ne.

Tina Ukëhaxhaj

# Opinione

## MODA ,STILI DHE VESHJA

Sot, një nga gjërat që i preokupon më së shumti adoleshentet është padyshim të dukurit bukur dhe moda. Se sa ka ndikim ajo tek të rinjtë, sa përcillet dhe sa i kushtojnë vëmendje, ja disa opinione të marra nga nxënës te shkollës :



**LEART ALICKAJ:** Sipas mendimit tim moda po përcillet nga të rinjtë çdo ditë e më shumë. Ajo luan rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit të të rinjve dhe ka ndikim të madh në jetën shoqërore të tyre. Njëra nga arsyet se përse te rinjtë e ndjekin modën është se njerëzit i kushtojnë rëndësi të madhe dukjes. Me anë të veshjes ne mund të nxjerrim detaje lidhur me karakterin e atij personi. Moda është diçka e bukur, por nuk duhet të kalojë në fiksime.



**AGNESA JASIQI:** Në shoqerinë tonë ka shumë probleme që ndikojnë në jetën e adoleshentëve dhe një ndër to është edhe moda. Secili adoleshent dëshiron të duket sa më bukur në stilin e tij dhe të pëlqehet edhe nga rrathi. Mirëpo përditshmëria luan rrollin kyç pasi që adoleshentët shkojnë çdo ditë në shkollë, dhe në këtë mënyrë ata duhet të mendojnë çdo ditë për dukjen e tyre e sidomos për veshjen. Gjithmonë ka diçka që pëlqehet nga shumica prej të rinjve e kjo mund të jetë një bluzë, një palë

pantallona apo diçka tjetër. Arsyja pse adoleshentët dëshirojnë të duken sa më bukur është se ata duan ta fshehin veten e tyre të vërtetë pas këtyre gjërave që janë në mode pasi që mendojnë se kështu ata do të pëlqehen dhe do të pranohen më mirë nga shoqëria. Mirëpo, unë mendoj që secili adoleshent duhet të veshë atë që dëshiron dhe që ndihet rehat në të, e jo atë që është në mode vetëm sa për t'u përshtatur më shumë në shoqëri.

## Opinione



**HANA DOBROSHI:** Pamja e jashtme është ajo që krijon mendimin e parë për një person. Moda është ajo që shpreh botën e brendshme të çdo njërit nga ne. Asnjë njeri nuk duhet të ngurojë që të vishet ashtu siç ai ndjehet rehat, por çdo gjë duhet të ketë një limit, ngase askujt nuk i pëlqejnë gjërat që kalojnë në ekstrem. Pra, meqë pamja e jashtme krijon mendimin e parë, thjeshtësia të ndihmon që ai mendimi të jetë shumë i mirë.

**ATLANTIDA MALOKU:** Zakonisht përshtypjet e para që kemi për njerëzit vijnë nga pamja e jashtme, andaj secili nga ne e shfaqim kujdesin për veten në mënyra te ndryshme. Moda është bërë rutinë

dhe temë e përditshme si për femrat ashtu edhe për meshkujt. Te meshkujt ky interesim filloi të shfaqet më vonë, por sot ata janë në hap me trendet e fundit. Ajo që sot karakterizon rininë tonë është se si e shfaqin karakterin, idetë dhe personalitetin e tyre me anë të stilit, të veshjes. Kështu, porosia ime do të ishte që secili nga ne të mbetet vetvetja dhe të mos shndërrohet në personalitet tjetër nën maskën e quajtur veshje.

**EDISON AVDIMETAJ:** "Asnjëherë në jetë nuk të jepet shansi i dytë për të kriuar përshtypjen e parë", prandaj veshja tek një person është shumë e rëndësishme sidomos tek djemtë që duan të jenë në qendër të vëmendjes. Në ditët e sotme njerëzit kujdesen shumë për pamjen e tyre të jashtme, por shpesh vishen në atë mënyrë që të ndihen sa më komod.

**IMRIT KASAPOLLI:** Moda ndryshon nga dita në ditë. Njerëzit që nga kohët e lashta janë përkujdesur për dukjen e tyre, por kjo gjë sot ka arritur kulminacionin për arsyen se njerëzit sot identifikohen nga pamja e jashtme. Të dukurit bukur për më tepër është ndjenjë e bukur dhe të ndjekësh hapat e modës të ndihmon te dukesh më mirë në sy të tjerëve, një kënaqësi më tepër kjo.



**DORENTINA UKEHAXHAJ:** Meqë moda ndryshon shumë shpesh, është pothuajse e pamundur t'i përshtatesh asaj gjithmonë, ndryshe do te na duhej ta ndryshonim stilin çdo ditë. Prandaj, mendoj që duhet kombinuar stilin tonë me atë çfarë ofron tregu, kështu do të ndiheshim mirë dhe unik. Po ashtu gjithmonë duhet pasur kujdes që të ndihemi rehat në rrobat që mbajmë veshur, sepse siguria dhe komoditeti të ndihmojnë që të reflektosh sa më bukur në sytë e të tjerëve e nëse kjo gjë nuk arrihet pak rëndësi ka moda.

Përgatiti: Arilda Shala

# Kronika

## 1. IX. 2011

Filloi viti i ri shkollor, 2011-2012. Edhe këtë vit si çdo vit tjetër janë bërë përgatitjet për një nismë të mbarë të vitit të ri shkollor. Që nga orët e para të ditës nxënësit kishin mbushur korridoret e shkollës sonë, ku përveç atyre që ishin pjesë e kësaj shkolle, kishte edhe shumë nxënës të rinj që ju bashkuan kësaj shkolle. Drejtoria e gjimnazit "Cambridge" i uroi të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit për një vit sa më të mbarë shkollor, me bindjen që edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, puna e përbashkët për ndërtimin e një të ardhmeje sa më të mirë do të sjellë suksese të mëdha.

## 18. XI. 2011

Gjimnazi jonë është vërtet i mbushur me plot e përplot nxënës të dalluar që jadin rezultate mahnitëse në mësime. Prandaj, si çdo vit tjetër, edhe këtë vit nxënësit që janë përpjekur më shumë në mësime fituan bursa shkollore. Nxënësit që fituan bursa janë:

Egzon Gacaferi, Agnesa Hasanaj, Alberina Draga, Arilda Shala, Leart Aliçkaj, Donika Lleshi, Irma Kullashi.

## 20.IX.2011

Për dallim nga vitet e mëparshme, këtë vit maturantët e gjimnazit "Cambridge", nën përcjelljen e një grupi mësimdhënësish, u nisen në ekskursion njëjavor ne Turqi.

## 20. X. 2011

Edhe këtë vit në gjimnazin tonë nuk munguan orët e mëdha letrare. Ora e parë letrare për këtë vit shkollor iu kushtua poetit të madh Naim Frashëri. Në këtë orë letrare u përkujtua me respekt të veçantë krijimtaria e Naim Frashërit. Kësaj ore të madhe iu bashkëngjitën edhe shumë nxënës që janë dashamirë të fjalës së shkruar artistike, të cilët me ëndje lexuan punimet e tyre.

## 28. X. 2011

Nxënësit e gjimnazit tonë përsëri e vazhduan traditën e festimit të Halloween-it. Të veshur me kostume të ndryshme, që e dëshmojnë kreativitetin e tyre të lartë, nxënësit së bashku me mësimdhënësit kaluan së bashku një natë festive të paharrueshme.

## 5.XII.2012

Disa nxënës nga gjimnazi "Cambridge" patën rastin të takohen me ambasadorin italian dhe t'i bëjnë pyetje të ndryshme rrëth interesimeve të tyre.

## 25.XI.2011

Erdhi koha e festës së veçantë, 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit, ku në praninë e shumë miqve të këtij gjimnazi u mbajt një program kulturo-artistik kushtuar kësaj festë.



## 21. XII. 2011

Nxënësit e gjimnazit tonë ka kohë që kanë dëshmuar një kreativitet të lartë. Këtë vit për herë të parë, me ndihmën e mësimdhënësve, u organizua një ballo që u quajt "Gala night" ku vajzat e gjimnazit tonë ngjasonin me princesha kurse djemtë me zotërinj të vërtetë. Kjo po që ishte një natë e paharruar.

# Kronika

## 23. XII. 2011

Përfundoi gjysmëvjetori i parë i vitiit shkollor 2011-2012 ku nxënësit përfunduan këtë gjysmëvjetor me sukses të shkëlgjeshëm u uruan nga mësimdhënësit dhe u inkurajuan edhe për më shumë punë në gjysmëvjetorin e dytë që do të fillojë më 10 janar 2012

## 10. I. 2012

Filloi gjysmëvjetori i dytë



## 23.III.2012

Edhe pse pak me vonesë për shkak të kushteve atmosferike, nuk u la anash aktiviteti i sportit në terren. Fillimisht nxënësit u mblodhën në oborrin e shkollës nga ku u nisen në destinacion e tyre të dëshiruar të quajtur "Brezovicë". Gjithmonë në përcjellje të nxënësve janë edhe mësimdhënësit.

## 7. III. 2012

Për ndër të festës së 7 Marsit-Ditës së Mësuesit dhe 8 Marsit-Ditës së Nënës, nxënësit e gjimnazit "Cambridge" shfaqën një program kulturo-artistik ku mbi të gjitha vlen të theksohet se nxënësit me ndihmën e mësimdhënësve krijuan edhe këngën e gjimnazit "Cambridge".

## 8. III. 2012

Pas festave, si çdo herë tjeter, filluan garat tradicionale të diturisë. Garat e diturisë filluan me klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë në lëndën e gjuhës shqipe ku nxënësit treguan rezultate të larta. Garat do të vazhdojnë me klasat dhe lëndët tjera. Për klasat që do dalin fituese drejtoria e gjimnazit ndan mirën johje.

## 23. IV. 2012

Përfunduan me sukses garat mësimore në të gjitha lëndët. Garat u mbyllën në një atmosferë të jashtëzakonshme pune ku të tri klasat synonin marrjen e pikëve maksimale.



## 23. IV. 2012 (foto e nx ne sallë)

Nën organizimin e Lidhjes Kosmunale të Sportit Shkollor, Pejë, filluan garat komunale në volejboll ku nikoqir ishte gjimnazi "Cambridge". Nxënësit e gjimnazit "Cambridge"

# Këndi poetik


## Ndjej si të harroj

Fshihesh pas zjarrit që tashmë është shuar

Shkrumbin e tij jeta e shpërndan në erë

Brenda teje shqelmon faj i penduar

Se thellë në brendi ndjehesh i pavlerë



Gjurmët e pendesës kërcasin rrugës

Tingujt e tyre unë në grusht i mbledh

Nuk mendon të sulesh në flakën e shuar

Se një here vjen koha kur jeta të thotë ZGJEDH

Në supet e tua bart heshtjen e ca kohëve

E ke si detyrim të mbash atë zjarr gjallë?

Apo tek ti përplaset furtunë e jetës

Që për kohëra dimrash të zgjon brenda mall

Pastaj shkujdesshëm ftoshesh përsëri

Prehesh në harresë në madhështinë e saj

Se zjarrin s'e mbajte dot të ndezur

S'të ndihmon aspak nëse ndihesh në faj

Alberina Draga XI 3

## LIBRI

Libri është i bukur

I dashur për çdo fëmijë

Ai ka gjetur strehim

Nëpër çdo shtëpi

Lexojeni librin

Thithni dituri

Libri është dashuri

Deri në përjetësi

Jeta Shoshi

## Shpirt i pafajshëm

Kaq vështirë është një zemër të pushtoj,

Përse gjithmonë duhet të vuash,

Përse gjithmonë kjo dhembje kur dashuroj,

Përse të dua është vështirë të thuash.



E ndjej çdo ditë më shumë,  
dridhem kur më afrohet,  
përse se ka vënë re se çfarë ndjej unë,  
përse një shpirt i pafajshëm lëndohet.

Një rrugë te gjatë para vetes kam,  
e vettuar duhet ta bëj,  
por forcën s'kam ku ta gjej.

Ndjej erën që më prekë flokët e mi,  
shoh dritën para syve të më zhdukët,  
a thua vallë edhe sa të pres do me duhet?

Arilda Shala -XI/2

## Leximi

Me lexim mendjene pasuron

Jeten e lumturon,

Fytyrën e ndriçon,

Prindërit i gëzon.

Me mësimet e mia,

Shumë gjëra të bukura krijoj,

Unë lexoj, një jetë të re krijoj.

Vlerri Beqaj kl.VI

## Këndi poetik

### Nëna ime engjëlli im

Ti je nënë engjëlli im  
Engjëlli i cili rri mbi mua  
Ditë dhe natë ti më ndriçon  
Unë të sjell dije ti më sjell  
buzëqeshje

Ditë e natë në megrim  
Athua ç'bën engjëlli im ?

Engjëlli im më çon  
Drejt paqes në liri  
Mendon për të ardhmen  
Time plot dituri

Sa herë në vit vjen 8 Marsi  
Dita e engjëllit tim  
Mendohem q'ti sjell  
Një dhuratë mos është e vogël?  
Një buzëqeshje mos është shumë e vogël  
Ajo më thotë mbushu plot dituri  
Dhe unë jam plot lumturi



Yllka Shoshi

### Kujtesë e rrënuar

Seç të rrenqeth trupin një ndjenjë  
E zemrës lehtas i flet me ngrohtësi  
Askush, askund s'të jep asnje shenjë  
Ashpër shpirtin ta kalon kjo ftohtësi  
  
Përmes syve të mbushur me mall  
Vështron atë horizont, çdo imtësi  
Në ëndrra dikush të vjen më rrallë  
Në listën e harresës befas u shtove ti  
  
Të ringjallet ndjenja e shkuar  
Të bren brenda rëndë të godet  
Në ëndrra erdhi dikush rastësisht  
Kurse ti në realitet sërisht vetëm pret  
  
Ndjehesh i përgjysmuar  
I humbur në harresë  
I ringjallur, por si i mallkuar  
Si duket ke mbetur vetëm në kujtesë

Evlina Kabashi

### Sytë blu

Në netët pa hënë  
Dy sy më kanë bërë roje  
Kur bota më lëndonte  
Ti për mua e shkatërruje

Kam pushtuar botën me njëren dorë  
Ndërsa tjetrën ma mbaje ti  
Nuk jam mësuar të gaboj  
Se ti gjithmonë ishe aty.

Më rikthehen kujtimet dhe asnje s'e  
Harroj  
Sepse ashtu siç dëshiron jam sot unë  
S'ka asgjë më të bukur në këtë botë  
Se sytë blu që i dua aq shumë.

Alberina Draga

### Mos më thuaj


Mos më thuaj në shkollë  
Që isha dikur  
Po të lutem shumë  
Mos e bëj zemrën gur  
  
Kurrë mos më thuaj  
Se jam në errësirë  
Kurr mos i thuaj  
Shkollës lamtumirë  
  
Kurrë mos thuaj  
Se shkollë më s'ka  
Mos të shkojë mendja  
Se ajo të la  
  
Mos lë veten pas  
As shkollën që të harrohet  
Se do të vije dita  
Kur mendja do të pendohët

Mirlinda Rrustemaj


Guras

# Portret në alfabet

## Naim Frashëri



**A** - Atdhetar – Në veprat e tij ai himnizon kombin e gjuhën



**B** - Busti - Në shumë qytete gjendet busti i Naimit, përfshirë edhe Bukureshtin.



**C** - Ciceron-Naim Frashëri është ciceron i letërsisë dhe gjuhës shqipe.

**Ç** – Çmuar-Veprat e vellezërve Frashëri janë shumë të çmuara.

**D** - "Dashuria" - Poemth i shkruar në greqisht që përbëhet nga 8 këngë, ku Naimi shpreh idetë dhe ndjenjat e tij për dashurinë dhe planin filozofik.

**DH** – Dhurat - Veprat e tij janë dhurata të çmuara, që ai ia dha letërsisë shqipe.

**E** - "Endërrime" - Vëllimi poetik i shkruar në persisht, dhe i botuar në vitin 1885.

**Ë** – Ëndrra – Ëndrra e tij e madhe ishte të punonte për atdhe.

**F** - Frashër - është vendlindja e Naimit.

**G** - Guximtar-mund ta quajmë edhe guximtar pasi ai mori guxmin për të shkruar shumë tekste për Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

**Gj** - "Gjithësia - Naimin e habit dhe njëkohësisht e mrekullon gjithësia, kjo shihet edhe te këto vargje të marra nga poezia me të njëtin titull-;

**A e shihni gjithësinë, yjet, diellin, hënën, Dheun, erën, retë, kohën, kashtën e kumterit, shenjën, Si janë përveshur gjithë edhe lecijn, e punojnë, Njëri-tjérit i ndihhmojnë, ashtu punën e mbarojnë.**

**H** - Horizonti-Horizonti i tij kulturor u zgjerua për së tepërtimi, njozu letërsinë, kulturën dhe filozofinë klasike greke e romake, filloj të përvetësonët greqishten e vjetër, latinishten, persishten dhe italishten.

**I** - Ideolog - Njëri nder ideologët që ia theksuan bektashizmit më tepër ngjyrat shqiptare ishte Naim Frashëri.

**J** - Janinë - Pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi në Janinë së bashku me familjen.

**K** – Kombëtar - Ai mban titullin "Poet Kombëtar"

**L** – Liria - Autori në veprat e tij përmend edhe lirinë dhe në një fjalë të urtë thotë: "Liria është që të mos të trazoj ty dhe ti të mos i trazosh të tjerët".

**Ll** – Llambë - Naim Frashëri me veprat e tij ndriçoi si një llambë e shndritshme mbi letërsinë shqiptare.

**M** - Mirënjoyje – Një numër i madh i shkollave të niveleve të ndryshme në territorë shqiptare mbajnë emrin Naim Frashëri.

# Portret në alfabet

**N**-Naim-Shumë fëmijë u pagëzuan me emrin e tij për meritat kulturore që la.


**NJ** – Njohuri-Ne, duke lexuar veprat e Naimit fitojmë njohuri të shumta për të kaluarën dhe marrim këshilla për të ardhmen.



**O** – Orator-Gjatë kohës kur Naimi jetoi merrej edhe me oratori dhe shquhej si orator.

**P** - Poemë - Naimi ka një numër të madh të poemave, por disa poema kanë zënë vend të rëndësishëm.

**Q** - "Qerbelaja" - Poemë heroike fetare e botuar me 1898. Porosia madhore e kësaj vepre shprehet me idenë se feja e vetme për të gjithë bektashinjtë apo të krishterët është dashuria për memëdheun.



**R** - Revolucionar - Naimi u bë një veprimtar revolucionar në të gjitha fushat, krijmtaria e tij letrare dhe kulturore ishte e lidhur më qirrimin dhe përparimin e vendit.

**Rr** - Rrefim-Naimi rrëfen edhe për Skenderbeun si një hero që gjithmonë do të mbetet gjallë dhe do të mbetet heroi ynë moral kombëtar.

**S** – Stamboll - Naimi vdiq në mëngjesin e 19 tetorit të vitit 1900 në Stamboll.

**SH** - Shqipëria - Poema Shqipëria cilësohet si poema e parë e Frashërit e botuar në vitin 1897 që i entuziazmoi patriotët shqiptarë

**T** - Tiranë - Në Tiranë prehen eshtrat e Naim Frashërit.

**TH** – Themelues-Po ashtu Naimi njihet edhe si themelues i gazetave *Drita*, *Dëshira*. Ai ndihmoi edhe botimin e shumë veprave të shkrimtarëve tanë, ndërkojë botoi edhe vet.



**U** – Udhëtimi –Naim Frashëri në disa nga poezitë e tij përmend edhe udhëtimin dhe thotë: “Stina më e bukur e dashurisë është udhëtimi”

**V** – Veprat - Veprat e këtij autori janë shumë të pasura dhe të larmishme si në tematikë ashtu edhe në tipologji. Naimi shkroi vepra në poezi dhe në prozë, në ligjërim lirik dhe në atë epik.

**X** – Xixëllues-poezitë e Frashërit janë poezi hyjnore me shkëlqim të artë në tematike dhe me pasqyrim të larmishëm në tipologji.

**Xh** – Xhevahir-Veprat e Naimit janë vepra që vlejnë me shumë se të gjithë xhevahiret që ka bota.

**Y** – Yll-Mbi vepra ka një dritë që shkëlqen dhe i bën ato më të shndritshme e ajo dritë vjen nga një yll lart, ai yll është Nam Frashëri.

**Z** – Zosimea – Naimi së bashku me vëllain e tij, Samiun, studiuau në gjimnazin grek “ZOSIMEA”.

**Zh** – Zhvillimi-Gjatë vitit 1850 zhvillimi më i madh i gramatikës nga Naim Frashëri u arrit me botimin e revistave dhe punën e Shoqërisë se Bukureshtit.

Përgatiti: Yvesa Jusaj

# Poezi të pavdekshme

## E pamundura

Ka njëzet vjet që ti mungon

Zbrazëtirën asgjë s'e mbush

Në tryezën e gjëzimit a të brengës sonë

Ka një vend ku s'ulet askush

Në aeroport të Rinasit nga ike

Pistat janë të shtruara gjithnjë

Të gjithë avionët ty të marrin


Por pas ty s'të kthen asnje

Veç mes gjëmimit të motorëve

Duralumini ndrit, drithëron

Zëri gjëmuar dhe buzëqeshja jote

Vijnë një çast dhe prapë shkojnë



Ismail Kadare

## Letrat

Kur dashuroheshim në kohën tonë,  
Kur tretesa dhe digjesha për ty,

Nga njëri-tjetri letrat  
vinin vonë,

Kalonte dhe një muaj  
apo dy.



Po ndofta dashuria

mbahej gjallë,

Se zjarrin mbanin  
letrat në udhëtim

Me biçikletë a mushkë apo me kalë

Në vapë e shi, dëbore dhe thellim.

Kur dashuroheshim në kohën tonë,

Me zor na vinin letrat fshat-qytet

Nuk kishim nëpër dhomë telefonë

Dhe në tëndërr s'kishte faks dhe internet.

Megjithatë më mirë që nuk kishte

As telefon, as internet, as faks,

Se fjalë e nisur shpejt dhe mund ta vriste

Një dashuri të vjetër për një çast.


Dritëro Agolli

## Malli

Syri i bukur që t'u mvrenjt  
Syri yt që më lëndon

Do më lërë a vonë a shpejt,

Do më lërë a shpejt a vonë.



Sapo shpirti mu dëlir  
Shpirti im i nxirë krejt  
Do më lërë me pahir  
Syri i bukur që t'u mvrenjt.

E do mbetem përnjëmend  
Varfanjak si mbret pa fron  
Mbrëtëresha që më çmend  
Do më lërë a shpejt a vonë.

Do më lërë a vonë a shpejt,  
Do më lërë a shpejt a vonë,  
Syri i bukur që t'u mvrenjt  
Syri yt që më lendon.

Do me lërë...Ah! po si  
Qoftë aherë ose tanë  
Do të qaj aq dashuri  
Qe të humb me mall te ti

Lasgush Poradeci

## Atdheu

Atdheu është dhimbje, është dhimbje.

Një prill i pikëlluar në shpirt.

Atdheu është kryqi, është kryqi.

E mban - dhe të mban ty - në shpirt.

Atdheu është toka e premtuar.  
Ti shkel si një zot dhe s'e ke ndën këmbë  
Atdheu s'ka fjalë, ka sy të trishtuar  
Vdes dashuria në dashuri që të çmend.

Atdheu është buka e uritur,  
të ikën nga duart e dot nuk e ngop  
ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur  
me sytë n'errësirë vetveten kérkon.

Atdheu është varr i hapur, është varr.  
Një jetë drejt tij shkon me besë që bind.  
Në një pikë loti mbyt lotin fatvrarë  
Në një pikë loti lirinë e lind.

Atdheu yt i vogli, i vogli,  
Ai hyjnori i pavdekshmi - loti.

Fatos Arapi

# Poezi të pavdekshme

## Vaje

Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë  
Lotët që kam derdhur, s'më janë dhe  
tharë

Shumë vjet u benë sot u mbushën dhjetë  
Që kur më ke lënë dhe s'të shoh në jetë!

Në ç'kopshte me lule ke qëndruar vallë?  
S'të vjen keq për mua? S'të vjen mall për  
djalë?

O ëngjell i bukur mos meno në botë  
Kthehu të të shomë, te na mbetën lot

S'rrojmë dot pa ty ne, ti si rron pa neve?  
Motëmot që rrojtëm bashkë, s'më urreve  
Atje tek rri janë qipariz' e varre  
Kthehu të të shomë mos na lërë përfare

Mos na lërë të gjorë me zemër të ngrirë  
Kthehu të gezohesh kur te shoq tët bir  
E ke lënë foshnje tanë u bë burrë  
S'arrite ta rritje s'të ka parë kurrë

Për ty shumë herë çoc do të më thotë  
Por s'mund ti pergjigjem se më mbytin lot  
Kthej kokën mënjanë dhe vështroj përpjetë  
Duke pshëretit te Zot' i vërtetë

O Zot i vërtetë, s'të erdhi keq për djalë  
Kur i more mëmën dhe më le të gjallë  
Te më keshe marr mua do të qe më mirë  
Dhe të rronte mëma të rriste të birë  
Me se rrojnë foshnjat? Çi rrit çiliminjtë?  
Dashuri e mëmës dhe përkedhelitë  
Doje dritë o qilli, more dritën time  
dhe ma mbushe jetën plot me hidhërimë  
Tani rroj pa shpresë ndaj s'dua të rroj  
Se dhe perendinë tanë s'e besoj.

**Andon Zako Çajupi**

## Dhe sikur

Dhe sikur në botë ti mos të ishe,  
Do jetoja si çdo gjë që jeton,  
Veç pa ty kjo botë do lëvizte  
Siç lëviz pa ngrohje një vagon.

S'ma zëvendëson ti botën mua,  
S'të zëvendëson as bota ty,  
Por sa botën sigurisht të dua,  
Kur jetojmë e vdesim tok te dy.

**Dritëro Agolli**



## Recital' i Malësorit

O, si nuk kam një grusht të fortë  
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë,  
ta dij dhe ai se ç'domethanë i dobët  
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.

Unë - lugat si hij e trazueme,  
trashigimtar i vuejtjes dhe i durimit,  
endem mbi bark të malit me ujen e  
zgjueme  
dhe me klithma te pakënaquna  
t'instiktit.



Mali hesht. Edhe pse përditë  
mbi lëkure të tij, në lojë varrimtare,  
kërkoj me gjetë një kafshatë ma të mirë...  
Por më rren shaka, shpresa gënjeshtare.

Mali hesht - dhe në heshtje qesh.  
E unë vuej - dhe në vuejtje vdes.  
Po unë, kur? Heu! Kur kam per t'u qesh?  
Apo ndoshta duhet më parë të vdes?

O, si nuk kam një grusht të fuqishëm!  
Malit, që hesht, mu në zemër me ia njesh!  
Ta shof si dridhet nga grusht i paligjshëm...  
E une të kënaqem, te kënaqem tu' u qesh.

**Migjeni**

## Përderisa je gjallë, ndjehu i/e tillë

Mos prit të mbarosh universitetin,  
të dashurohesh,  
të gjesh një punë,  
të martohesh, të kesh fëmijë, ta shohësh  
veten të sistemuar,  
të humbësh ato dhjetë kilogramë,  
që të vijë darka e të premtes apo mëngjesi i së shtunës.  
Nuk ka moment më të mirë se ky për të  
qene i/e lumtur.



Lumturia është një rrugëtim, jo një destinacion.

Puno sikur të mos kesh nevojë për para,  
dashuro sikur të të mos kenë lënduar kurrë,  
dhe kërce, sikur të të mos shihte njeri.  
Kujto se lëkura rrudhet  
flokët bëhen të bardhë dhe ditët bëhen vite.  
Por kryesorja nuk ndryshon:  
Forca dhe bindja jote nuk kanë moshë.  
Shpirti yt është ai që largon tutje çdo ngatërrresë që mund të  
jetë krijuar në të.

Pas çdo fundi ka një fillim te ri.  
Pas çdo arritjeje ka një sfidë tjetër për tu kapërcyer.  
Përderisa je gjallë, ndjehu i/e tillë.

Shko përpara edhe kur të gjithë presin rrëzimin tënd!!

**Nënë Tereza**

**G u r a s**

# Muzikë

Marshall Bruce Mathers III – Eminem ( 17 Tetor 1972 )


Shumë të vërteta janë thënë në një gënjeshtër...



Është njëri ndër reperët më të mirë të botës. Ai që në moshë të hershme kishte një pasion të madh për repin, deri sa një ditë pasioni i tij u shndërrua në një realitet tashmë të pabesueshëm për të. Ndonëse ai përdorte ndodhitë e jetës së tij për të krijuar këngë të cilat u pëlqyen jashtë mase e që vazhdojnë të dëgjohen edhe me tutje duke e bërë atë të veçantë dhe shumë të kërkuar në gjithë botën, edhe pse me një jetë me shumë probleme që e bënë nganjëherë të largohej nga skena muzikore ai nuk e braktiste kurrë atë, ai rikthehej përsëri edhe më i fuqishëm duke u bërë i dashur për shumë njerëz që ju dhuronte hite të mëdha dhe kështu duke mos i zhgënjiyer asnjëherë. Ai akoma vazhdon të jetë reperi më i kërkuar në botë duke u adhuruar nga miliona njerëz.


## BIOGRAFIA

Marshall Bruce Mathers III u lind më 17 tetor 1972, Kansas City, Missouri, USA. Biri i një nënë pesëmbëdhjetë vjeçare në kohën e lindjes së tij dhe një babai i cili u largua gjashtë muaj më vonë për të mos u kthyer kurrë më, në moshën 12 vjeçare u vendos në lindje të Detroitit. Marshall u zhvendos në shumë vende duke bërë kështu që ai të ndërronte edhe shumë shkolla; koha maksimale që ai kaloi në një shkollë ishte 3 muaj, ai u keqtrajtua në çdo shkollë dhe pas dështimit në klasën e 9 për tri herë me radhë, ai la shkollën, por duke thënë që ai nuk e konsideron veten budalla, por i këshillon njerëzit që nuk duhet të ndjekin shembullin e tij. Ai thotë se ajo thjesht nuk ishte për atë. Kështu ai u largua për të punuar në atë qe ai ishte më i pasionuar, pas repit. Ai që në moshën 4 vjeçare dëgjonte muzikën rep, ishte ëndrra e tij që një ditë të jetë një reper dhe kështu në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare ai bëri një emër për veten e tij, duke e bërë "M & M", Emri i erdhë nga inicialet M (arshall) M (athers), të cilën ai më vonë e risolli si "Eminem". Ai ishte martuar me të dashurën e tij Kimberly Anne Scott më 14 qershor 1999 dhe i kishte lindur një vajzë, por u divorcuan më 11 tetor 2001. Gruas se tij Kimberly Mathers i ishte dhënë kujdestaria e vajzës së tyre 5-vjeçare, por po këtë vit ai mori kujdestarinë e përbashkët për Hailin dhe ishte Hailie aryse për ribashkimin e tyre me 14 janar 2006, por përsëri një martesë e dështuar. Ata divorcohen përsëri më 19 dhjetor 2006. Një dëshirë e tij është që vajza e tij, Haile Jade të bëhet një aktore dhe për dashurinë që ka për të ai ka një tatuazh të vajzës së tij mbi shpatullën e tij te djaththë. Ka një gjysmë motre e një gjysmë vëllai në anën e babait të tij, Sara dhe Michael Mathers. Ka kujdestarinë e mbesës së tij Alaina (Lainie). Lainie dhe Hailie vajza e tij janë sjellë së bashku dhe janë konsideruar motra dhe ai i referohet edhe si bija e tij. Lainie është përmendor në Mockingbird këngë në album "Encore". Ai ka pasur një operacion në gju të tij, që coi në qëndrim të vështirë në shfaqje të shumta. Kompania e tij rekord është quajtur Shady Records. Për të ndihmuar mbështetjen e nënës së tij, Marshall i ri punoi si një kuzhinier në një restorant familjar Michigan të quajtur shtëpizë Gilbert. Historia vazhdon të shkruhet akoma, sepse ai është një ikonë e rep-muzikës. Në MTV është renditur si një ndër 7 ikonat më të mëdha të historisë, i cili po ashtu ka shënuar më shumë se 1 miliard klikime ne you tube.




## Karriera muzikore

Menjëherë filluan probleme të mëdha. Ai u hodh poshtë gjatë gjithë kohës nga njerëzit për shkak të racës së tij edhe pse ai ishte një reper vërtetë i talentuar. I vendosur që të provojë të tjerët gabim, ai kërkonte të gjithë në radio që të tregojë veten me betejat "freestyle" (stil i lire) ku dhe doli kreu i këtij stilit. Në vitin 1995 regjistroi albumin e tij të parë me titull "Infinite", i cili është shitur më pak se një mijë kopje. Në të njëjtin vit, e dashura e Marshallit, tanj gruaja, Kim, lindi fëmijën e tij të vetëm, Hailie. Ato kohëra ishin të vështira për të. I dëshpëruar që nuk gjente para për të mbështetur Hailie dhe Kim ai kishte thyer banesën e tij dhe tashme nuk dinte se ku do të jetonte, derisa një ditë përdori monedhën e tij të fundit; ai hyri në Lojërat Olimpike 1997 në Los Angeles Rap duke shpresuar te fitonte çmimin prej \$1500 para në dorë e që për të ishin shumë të nevojshme. Pas luftës prej 1 ore ndonëse i bindur që do fitonte, një gabim e dërgon atë në vendin e dyte. I inatosur nga humbja, Marshall nuk e vërente se në turmë ishin disa nga prodhuesit e Interscope, të cilet i dorëzuan një kopje të kasetë "Infinite" Dr Dre. Ai e mori për të dëgjuar atë dhe përfundimisht zbuloi gjithë talentin që fshihej pas tij. Dr. Dre ftoi Marshall për të punuar së bashku dhe shënuan katër këngë në gjashtë orët e para të punës duke përfunduar kështu edhe albumin e dytë të quajtur "The Marshall Mathers LP". Mirëpo këtu nuk përfundon gjithçka pasi qe Dr.Dre kishe mbetur i impresionuar nga talenti i pazakontë i Marshall.-it Ai i kërkoi atij që të punonte me të për albumin e tij të ri. Ata bashkëpunuan në disa këngë, që ishin këngët më të mira të albumit. Kjo ndikoi në ndërtimin e karrierës se tij, dhe vazhdoi duke punuar për albumin e tij të trete ,..... Mathers LP Marshall..... ne vitin 2000. Aty u paraqitën artistë të tillë si: Dre, Snoop Dogg, X-Zibit, Nate Dogg, D-12 dhe Dido. Ky album debuton si i pari në tabelën e alumeve në SHBA , ai ishte nominuar për 4 çmime Grammy : Best Rap Album, Best Rap Solo Performance dhe Best Rap Performance nga një Duo apo Grupi përrugën e "Forget About Dre" me Dr Dre, fitoi tre Grammys dhe ishte albumi i parë rap që ndonjëherë u emërua "Album i Vtit", duke shitur më shumë se 8 milion regjistrime vetëm në Amerikë. Një sukses tjetër i madh ishte filmi 8 Mile i bazuar në jetën e tij. Në vitin 2002 ai nxori albumin e tij të katërt me radhë "The Eminem Show", që ishte albumi më i shitur i vitit 2002; u shitën 9.9 milion kopje po ashtu u rendit ne listën e Rolling Stone's e 500 alumeve më të mëdha të të gjitha kohëra; po ashtu u rendit ne numrin e 84 alumeve më të mira neë revistën e dekadës 2000. Sukseset tashme ishin te pashmangshme. Viti 2003 i solli edhe një sukses me këngën e tij "Lose Yourself", si interpretuesi i parë hip-hop mori çmimin për këngën më të mirë originale. Viti 2004 e gjen atë me albumin "Encore", i cili arriti të shitej në 11 milion kopje. Reperi tashmë me famë botërore po kalonte ne disa periudha jo fort të mira për të pasi kishte anuluar turneun evropian nga data 1 – 17 shtator me 50CENT dhe ai ishte i shtruar në spital nën kujdesin e mjekëve për varësinë nga ilaçet e gjumit. Vitet në vazhdim ishin vite dëshpëruese për Eminemin sidomos viti 2006 pas vdekjes së mikut të tij De Shaun Holton, që u vra në moshën 32 vjeçare, duke berë që ai të binte në depresion. Vitet tjera qe vijnë pas e gjejnë pothuajse njëjtë, në një depresion akoma të pa kaluar ndërkohë që adhuruesit e tij prisnin një album nga ai , prisnin me padurim atë album të shihnin si ishtejeta e tij pas vdekjes se mikut te tij dhe pas divorcit me gruan e tij. Një pritje e tillë vazhdoi deri në vitin 2009 me albumin e tij "Replase" dhe ai filloj te ringjallej. Një ringjallje e madhe ishte viti 2010 me albumin e tij të shtatë "Recovery". Fillimi i regjistrohet si vazhdim i "Replace", por ky ka më shumë karakteristika medituese dhe emocionale sesa paraardhësit e tij. Ky album mbart me vete hite të mëdha si "not afraid", hitin ndërkombëtar me Lil Wayne "No love" dhe një hit tjeter me këngëtaren Rihanna "love the way you lie" që e sollën në dy versione. Ky album u shit në 5.7 milion kopje në mbarë botën po ashtu ishte albumi më i shitur dixhital i të gjitha kohërave.



## Film



### GiRL in PROGRESS

Grace është nënë begare. Ajo është shumë e zënë me punën, faturat dhe me burrin e saj Dr. Harford për t'ia kushtuar vëmendjen vajzës së saj Ansiedad kur ajo kishte nevojë. Kur mësuesja e anglisches e Ansiedad tregon një histori të vjetër per kalimin e mashës Ansiedad inspirohet duke e kaluar adoleshencën dhe duke filluar jetën pa nënën e saj. Shoqja e saj e ngushte Tavita e ndihmon me këtë plan mirepo kur gjërat s'i shkojnë ashtu si deshi ajo Ansiedad dhe nëna e saj Grace duhet të mësojne se për t'u rritur duhet të veprosh sipas moshës ...

Eva Mendes Cierra Ramirez  
• Lionsgate & Pantelion Movie



### Stars

Chris Brown Ne-Yo  
Keri Hilson Keri Rowland  
Kevin Hart Terrence J

### Gabrielle Union

• Screen Gems &  
Rainforest Movie

Bazuar ne librin e Steve Harvey 'Think like a Man', katër burra te ndryshem qëjeta e tyre e dashurisë tronditet, ngase zonjat blejne librin e Harve-it dhe fillojne t'i marrin këshillat e tij me seriozitet. Kur grapi i burrave mësojne se jane tradhtuar nga njeri prej tyre bëjnë komplot duke përdorur informacionin e librit për t'ju mësuar zonjave një mësim të tyre ...

### Coming Soon

#### Movies u must see ☺

- |                    |                     |                        |               |
|--------------------|---------------------|------------------------|---------------|
| • LoL              | • One for the money | • Jonny English Reborn | • Soul Surfer |
| • The Vow          | • Honey II          | • Abduction            | • In Time     |
| • American Reunion | • The Avengers      | • Valentiens Day       | • Fast Five   |
| • Marley           | • Jack and Jill     | • Change –up           | • Step up III |
| • The lucky one    | • Hangover II       | • Big momma III        |               |

# Sport

## Kupa Botërore

Kampionati Botëror i futbollit për meshkuj, zyrtarisht FIFA World Cup , është një turne futbolli për ekipet kombëtare, në të cilin çdo katër vjet vendoset “Kampioni i Botës”. Organizator është trupi i futbollit botëror *FIFA*. Raundi final - një ngjarje rreth katër javë – vlen, pas Lojëra Olimpike, si ngjarja më e rëndësishme sportive në botë. *Kampion Botëror* në fuqi është Spanja. Raundi i fundit final i Kupës Botërore të futbollit u mbajt në Afrikën e Jugut në vitin 2010 dhe raundi i ardhshëm i Kupës së Botës 2014 do të zhvillohet në Brazil.

Për të marrë pjesë në kampionatin botëror, kombëtaret duhet së pari t'i nënshtrohen një kualifikimi (shteti organizator dhe kampioni i botërorit paraprak kualifikohen automatikisht). Në kualifikim marrin pjesë të gjitha shtetet, kombëtaret e të cilave janë të pranuara nga *FIFA*. Ato luajnë kundër njëra tjetërs të organizuar në fillim sipas kontinenteve, shtetet e së cilave janë të ndara në nëngrupe.



Botërori i parë u mbajt në vitin 1930 në Uruguai. Historia e futbollit fillon para 100 vjetësh. E gjitha filloj në 1863 në Angli, ku futboli amerikan dhe futboli evropian morën dy rrugë te ndryshme, gjë e cila themeloi Shoqatën e Futbollit ne Angli (Britaninë e Madhe). Të dy llojet e futbollit filluan nga një rrënje, por u zhvilluan në dy degë të ndryshme. Në kohët e mëparshme quhej tepër natyrale të gjuaje topin me dorë dhe ky veprim nuk kërkonte dhunti. Në të kundërtën, futja e gjithë pjesëve të trupit në përfjashtim të duarve, kërkonte përgatitje të vecantë fizike dhe talent për shkak te vështirësive teknike të lojës. Për këtë futbollit cilësohet sporti më i adhuruar në botë.



Një nga rregullat kryesore të Kampionatit Botëror është se trofeu duhet t'i kthehet *FIFA*-s pas përfundimit të çdo kampionati dhe lejohet të mbahet vetëm nëse e fitoni 3 herë. Këtë e ka arritur vetëm Brazili, i cili njëkohësisht ka fituar 5 trofe dhe gjendet në vendin e parë sa i përket kësaj statistike. Pas Brazilit vjen Italia me 4 trofe të fituar, Gjermania me 3 trofe, Argjentina dhe Uruguai me nga 2 trofe dhe Anglia, Franca dhe kampioni i tanishëm Spanja me nga 1 trofe te fituar.

Qysh nga zanafilla e këtij kampionati ekzistojnë dy Trofe, i pari është fituar 3 herë nga Brazili dhe kështu ata e kanë marrë atë dhe që nga viti 1974 fituesit i është dhënë Trofeu i Ri, i cili u jepet ekipeve deri më sot.



Pos Trofeut të kampionit jepen edhe çmime të tjera si “Golashënesi më i mirë”, “Lojtari më i mirë” dhe nga viti 2006 edhe çmimi “Lojtari më i mirë i ri” për këtë çmim kanë të drejtë të garojnë vetëm lojtarët që marrin pjesë për herë të parë në kampionat dhe të cilët duhet të janë nën moshën 21 vjeçare.

Gjithë Bota e pret me padurim Kampionatin Botëror 2014, në të cilin për rreth një muaj do të këtë shumë gola, emocione dhe momente të paharrueshme, të cilat do të mbesin për një kohë të gjatë në kujtesën tonë.

**Punuar nga : Leart Aliçkaj dhe Avni Zeqiraj Kl: XI-2**

# Thënie të mençura



S'ekziston asnjë copëz dëshmie se jeta është diçka serioze.

**Brendan Gill**

Kur jemi të lumtur, jemi gjithmonë të mire; por kur jemi të mire nuk jemi gjithmonë të lumtur.

**Oscar Wilde**

Zemra e njeriut ka kufi në dashuri, por jo edhe në urrejtje.

**Honore de Balzac**

Njerëzit zakonisht besojnë më shumë atë që duan.

**Cezari**

Duke e bërë njeriun pronë të saj, kafsha kënaq egoizmin e vet.

**L. Vovenarg**

Njeriu është një qenie komplekse; ai bën shkretëtirat të lulëzojnë dhe liqenet të thahen.

**Gil Stern**

Të mos kesh shokët të pabarabartë me veten

**Confucio**

Buzëqesh edhe pse buzëqeshja juaj është e trishtueshme, sepse më e trishtueshme se një buzëqeshje e trishtuar është trishtimi kur s'buzëqesh kurrë.

**Jim Morrison**

Në qìll nuk mbërrijnë kurrë fjalë pa mendime.

**William Shakespeare**

I mençur do të thotë të matësh kohën dhe fjalët.

**Zhan de la Fonten**

E rëndësishme është gjallëria e përjetshme, jojeta e përjetshme.

**Fridrih Nietzsche**

Jetesën e bëjmë nga ato që marrim, jetën e bëjmë nga ato që japidim.

**Winston Curchill**

Vdekja është barazia e të pabarabartëve.

**Jankelevitch**

Të duash dhe të të duan do të thotë të ndjesh diellin nga të dy anët.

**David Viscott**

Krenaria e pamasë është maskë e një shpirti bosh.

**Ivan Turgeniev**

Vetëm e vërteta është e bukur.

**Decarti**

Vetmia është të dëgjosh erën dhe të mos mundesh t'uа tregosh të tjerëve.

**Jim Morrison**

I vetmi njeri që kurrë nuk bën gabime është njeriu që nuk bën asgjë.

**T. Rusvelt**

Nëse një njeri rri duke menduar për gjendjen e tij fizike apo morale, ai zakonisht zbulon se është sëmurë.

**Göte**

Arti nuk mësohet. Në art nuk ka mësues.

**Stanislavski**

Në shaka gjithmonë fshihet një qëllim serioz.

**Vales**

Përgatiti: Alberina Draga

G u r a s

## A e dini se

### Kuriozitete te ndryshme nga BOTA!

- Megjithëse në botë ka më shumë se 600 milionë telefona, gjysma e botës ende nuk ka bërë asnjë telefonatë.
  - Në Ditën e Nënave në SHBA bëhen më tepër telefonata personale se në çdo ditë tjetër në çdo shtet tjetër.
  - Në 1870 në Londër jetonin më shumë Irlandezë sesa në Dublin.
  - Mundësia për të të rënë rrufeja është 1 në 600,000
  - Rreth 27% e ushqimit në vendet e zhvilluara përfundon në koshat e plerave.
  - Gjysma e popullisë së botës është nën moshën 25 vjeç.
  - Në Perëndim njerëzit ndërrojnë shtepi mesatarisht 1 herë në 7 vjet.
  - Mesatarisht në botë shkohet në shkollë 200 ditë, në SHBA 180 ditë, në Suedi 170 ditë, në Japoni 243 ditë.
  - Që nga viti 1972 janë prodhuar rreth 64 milionë tonë kanaçe alumin(rreth 3 trilion kanaçe). Nëse këto do të vendoseshin njëra pas tjetrës, mund të arrinin deri në hënë rreth 1000 herë. Kanaçet e alumint përbëjnë 1% të materialeve mbeturina.
  - Në Australi ka më shumë se 150 milionë dele dhe një popullsi prej rreth 17 milionësh.
  - Në Zelandën e Re ka 4 milionë njerëz dhe 70 milionë dele.
  - Në krahun e një majmuni ka rreth 25 milionë qime.
- Në shoqërinë e sotme njerëzore fliten 2796 gjuhë të ndryshme. Ato ndahen në 11 grupe kryesore dhe 50 grupe "gjuhësh të vogla". Njerëzit që flasin këto gjuhë përdorin rreth 8000 dialekta.
- DNA ka një madhësi prej 1 të mijtat e milimetrit, përbhet prej rreth 200 miliard atomesh dhe përmban 1 milion faqe njojuri.
  - Një njeri harxhon mesatarisht 3 vjetë të jetës ne banjo.
  - Peshqit e harrojnë çdo gjë që ndodhen vetëm pas 10 min.
  - Një njeri i rritur merr frymë afërsisht 25 000 herë në ditë
  - Kompjuterat modern janë ndërtuar duke u bazuar në sistemin nervor, por edhe kompjuteri modern nuk i afrohet as nivelit të nje zvarritësi.
  - Mjalti mund të qëndrojë pa u prishur 3000 vjet dhe për këtë arsyе dylli i mjaltit përdoret për procesin e mumjazimit.

## F a b u l a

### DASHURIA E NËNËS

Një ditë, ndërsa frynte një erë e madhe,

Nga degët e një peme u rrëzua një fole me dy zogj

Të vegjël brenda. Macja që po kalonte aty praën, mjaulliti e gëzuar përfat që i kishte trokitur dhe zgjati kthethrat të kapte zogjtë e vegjël që po dridheshin të tmerruar. Befas, nga degët e pemës, u shkëput me shpejtësi vetëtime, mëma e zogjve dhe filloj të luftonte çmendurisht, gjersa macja u largua.

*Morali: Dashuria për e nënës përfëmijen i bën ballë çdo egërsie.*

## FIDANËT E ULLIRIT

Një plak po mbillte ca fidanë ulliri. Kaloi aty praën një djalë i ri dhe po e vështronte i çuditur plakun.

o gjysh,- e pyeti djali,- vërtet beson se do t'i shijosh kokrrat e këtyre ullinjve?

Unë jam i moshuar,- tha plaku. – Por mbollën të tjerët që të ha unë dhe tani po mbjell unë, që të hanë të tjerët.

*Morali: Jeta merr kuptim kur lë pas diçka për ata që do të vijnë pas teje.*

## G u r a s

# GALERIA JONË

